



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:175352

Datë: 07.11.2024

Numri i dokumentit: 06415943

**C.nr.3032/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.M. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. N.C. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shtesave mbi bazën e kualifikimit/gradimit, vlera e kontestit 2,047.95 euro, jashtë seancës, me datë 07.11.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses S.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, **DETYROHET** e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 01.06.2021 deri më datë 06.02.2023 apo për 20 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë 421.00 euro, t'ia paguajë shumën prej **1,107.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 20.06.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

**II. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 01.01.2020 deri më datë 31.05.2021, në shumën prej 940.95 euro, **si e pa bazuar**.

**III. DETYROHET** e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Paditësja S.M. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. N.C. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi kompensimin e shtesave mbi bazën e kualifikimit/gradimit, vlera e kontestit 2,047.95 euro.

Në referatin e padisë i autorizuari i paditëses ka theksuar se paditësja që nga vitin 2012 është marrëdhënie pune pranë SH.F.M.U. “Mati Logoreci” në Prizren, Si e punësuar në institucionet publike arsimore në Komunën e Prizrenit, e njëjta i ka plotësuar kushtet nga neni 4 i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 29.08.2008 dhe si Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë e vitit 2017 si dhe 2021 për kompensimin e shtesave mbi bazën e kualifikimit. Më tej ka theksuar se paditësja mbi pagën bazë prej 421 euro, për kualifikim nga e paditura është paguar vetëm 58.32 euro, por jo edhe shumën prej 27% të pagës bazë apo 113.67 euro, Kësisoj pala e paditur deri më tani nuk ka arritur të përmbush obligimin ligjor shumën prej 55.35 euro për çdo muaj dhe atë nga data 01.01.2020 deri më 06.02.2023 në total prej 25 muajve (25 muaj x 55.35 euro = 1,383.75 euro). Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, provat e ofruara i propozon gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar sipas tarifës së avokatisë.

I autorizuari i paditëses së fundmi me parashtrësën e datës 02.07.2024, e ka bërë precizimin e padisë ashtu që ka kërkuar që paditëses t'i njihet e drejta e kompensimit të pagës mbi bazën e kualifikimit, në shumë prej 55.35 euro për çdo muaj në pagën bazë prej 421.00 euro, nga data 01.01.2020 deri më 06.02.2023, në total prej 37 muajve (37 muaj x 55.35 euro = 2,047.95 euro).

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi deri më 06.02.2023, janë ta pabazuara për arsye se në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 e datës 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet trajtuar deri me datë 21.11.2022, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese Po ashtu ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi për kualifikim dhe licencim është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës

të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Neni 7 i Kontratës Kolektive të Arsimit e përcakton licencimin në bazë të së cilit fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional, e assesi të drejtë për kompensim shtesë, apo obligim financiar ndaj këtu të paditurës Komunës së Prizrenit. Gjithashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të kualifikimit për vitin 2020 është parashkruar, sepse sipas nenit 353 të LMD-së kjo e drejtë është parashkruar sepse kanë kaluar mbi 3 vite, andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja S.M. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse pranë SH.F.M.U. “Mati Logoreci” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose gradimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose gradimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata nga vërtetimi numër 239/24, e datës 16.05.2021, ka vërtetuar se paditësja S.M. është në marrëdhënie pune pranë SH.F.M.U. “Mati Logoreci” në Prizren nga data 19.09.2012, kualifikimi i paditëses është kualifikimin universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e Edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1306, e datës 16.11.2017, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i biologjisë dhe ka licencë të karrierës. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *“shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi,

përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 58.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësi përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur për 20 muaj nga data 01.06.2021 e deri më datë 06.02.2023, në shumë të përgjithshme prej **1,107.00 euro** ( $20 \times 55.35 = 1,107.00$ ) euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kumatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 20.06.2024, bazuar në Mendimin Juridik për Kumatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 20.06.2024, ndërsa kërkesa e saj ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit nga data 01.01.2020 deri më 06.02.2023. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2020 deri më datë 31.05.2021. Më

konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar në shumën prej 940.95 euro.

Ndërsa me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 20.06.2024 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.06.2021 e deri më 06.02.2023, gjykata konstaton se parashkrimi për kërkesën e paditëses për muajin qershor 2021 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që e njëjta ka pranuar pagën e qershorit 2021, e cila pagë realizohet në fund të muajit rrjedhimisht e njëjta atëherë është njoftuar se e paditura nuk ka përmbushur detyrimin për kompensimin e kualifikimit për muajin qershor 2021 dhe nga fillimi i muajit vijues saktësisht korrik 2021, e njëjta ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimin, në bazë të nenit 342 të LMD-së, ku parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”* rrjedhimisht këtu paditësja nga fillimi i muajit korrik 2021 ka pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit nga këtu e paditura, e që nënkupton se padia e paditëses për periudhën 01.06.2021 e deri më 06.02.2023, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses sikurse në pikën nën I të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2024:175352, 07.11.2024**

**B.profesional**

**Ali Kosova**

**Gjyqtari,**

**Agron Karatash**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2024:175352  
Datë: 07.11.2024  
Numri i dokumentit: 06415943